



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

---

Numri i lëndës: 2021:022229

Datë: 26.06.2024

Numri i dokumentit: 05862515

2021:045017

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i përgjithshëm – gjyqtarja e vetme gjykuese Hakile Ilazi si dhe zyrtari ligjor Ymri Ibrahim, në çështjen penale kundër të pandehurit B.R., për shkak të veprës penale në vazhdim vjedhja e rëndë nga neni 315 par.1, nën par.1.2 të lidhur me nenin 77 KPRK-së, sipas aktakuzave të Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.II.nr.120/2021 e datës 08.03.2024 dhe PP/II.nr.678/2021 e datës 07.05.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik, në praninë e prokurores së shtetit Besnik Nuredini, të pandehurit B.R. me datë 14.06.2024, mori dhe publikisht komunikoi, kurse me datë 24.06.2024 përpiloi me shkrim këtë:

AKTGJYKIM

I akuzuari B.R. i lindur me .. në Ferizaj, nga i ati S.. dhe e ëma M.. , me vendbanim në Prishtinë, ka të kryer shkollën fillore, me profesion i pa pune, i gjendjes së dobët ekonomike, punëtor në hotelin “G..”- V.., Prishtinë, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal 1.., ka qëndruar në ndalim nga data 24.04.2021 deri me datën 26.04.2021.

## ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me dt... rreth orës 20:00 në lagjen “R..” nr.13 ne Durrës te Shqipërisë saktësisht në banesën e te dëmtuarës D.Sh ,i pandehuri duke përdorur forcë me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo tjetrin ia merr pasurinë të dëmtuarit, në atë mënyrë që duke depërtuar me forcë ka hapur dritaren e ballkonit me mjetë te forte ka depërtuar brenda ku kishte demoluar orenditë dhe nga aty kishte arritur te marrë portofolin me një shume te parash kesh rreth 150 franga zvicerane te dëmtuarës D.Sh.

### II.

Me dt. 21.08.2020 rreth orës 17:30 në plazhin e Durrësit ne Shqipëri afër “H..” i pandehuri me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete dhe tjetrin, ia merr pasurinë të dëmtuarve, në atë mënyrë që shfrytëzon rastin e mos prezencës së të dëmtuarave tek çadra ne plazh, dhe nga aty ka arritur të marrë në një qante me mbishkrimin “Calvin Klein” ngjyrë e zezë që kishin qenë të vendosur katër celular, dy aparat celular në pronësi të dëmtuarit B.I., njëri i tipit “Iphone 7”, ngjyrë e zezë me numrin e telefonit të kompanisë telekom me nr. +... dhe tjetri i markës “Iphone 5 S” ngjyrë flori, si dhe dy telefona celular në pronësi të J.B. njëri i markës Huae 16 ngjyrë e zezë me kartë të kompanisë telekomit me numër +..0, dhe tjetri i tipit “Samsung” A10 ngjyrë e zezë me kartë të kompanisë telekomi me numër +3..., si dhe një shumë të hollash kesh rrethe 150 lekë të reja, 300 dinarë dhe 5 euro si dhe çelësin e dhomës të Hotel V. me nr. ....

### III.

Më datë 24.04.2021, rreth orës 18:00, në rrugën “B.R.” Ferizaj, saktësisht në marketin “P.. Market”, i pandehuri me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete ia merr pasurinë të dëmtuarës marketit “P..”, në atë mënyrë që nga raftet merr gjashtëmbëdhjetë (16) çokolata të markës “Milka”, duke i futur nën rroba dhe tenton të del pa e bërë pagesën, në atë moment kapet nga punëtori i sigurimit të marketit, me këtë i ka shkaktuar dëm material të dëmtuarës në shumën prej 32,00 €,-

#### IV

Me datë, kohë dhe vend të njëjtë si në dispozitivin I saktësisht në zyrën e sigurimit të marketit “P.”, i pandehuri me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete, të dëmtuarës L.M. i merr telefonin e markës “Iphone 6 S Plus” duke i shkaktuar dëm material në shumën rreth 100,00 €.

#### V

Me datë, kohë dhe vend të njëjtë si në dispozitivin I saktësisht në zyrën e sigurimit të marketit “P.M.”, i pandehuri me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete, të dëmtuarës E.H. i merr telefonin e markës “Samsung Galaxy S6 Edge” duke i shkaktuar dëm material në shumën prej 200,00 euro.

#### VI

Më datë 24.04.2021, rreth orës 21:00, në rrugën “A..”, Ferizaj, saktësisht në marketin “..”, i pandehuri ia merr pasurinë të dëmtuarës me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete, në atë mënyrë që nga raftet e marketit merr një aparat të kafesë të markës “Kimbo Espresso Italiano” dhe tridhjetë kapsulla të kafesë, duke dalë pa e bërë pagesën, me këtë i ka shkaktuar dëm material të dëmtuarës marketit “V.F.”, në shumën prej 80,00 €,-

#### VII

Më datë 24.04.2021, rreth orës 23:20, në rrugën e “...” Ferizaj, saktësisht në marketin e “H.P.”, i pandehuri ia merr pasurinë të dëmtuarës, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete, në atë mënyrë që nga raftet merr një shishe të alkoolit “JackDaniels” me çmim rreth 32 € dhe del pa e bërë pagesën, me këtë i ka shkaktuar dëm material të dëmtuarës në shumën prej 32,00x €.

-me të cilën ka kryer veprën penale vazhdim vjedhja e rëndë nga neni 315 par.1 nën par.1.2 lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

-Prandaj, gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 43, 69 dhe 70, 71,72 të KPRK-së, dhe nenit 364 të KPPRK-së të akuzuarin e:

## **G J Y K O N**

**DËNIM ME BURGIM** në kohëzgjatje prej 12 /dymbëdhjet/ muaj, i cili dënim do të ekzekutohet brenda afatit prej 30/tridhjetë/ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

**DENIM ME GJOBE** – në shumën prej 400 / katërqind / €uro i cili dënim duhet të paguhet ne afatin prej 30 /tridhjetë/ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk mundet apo nuk dëshiron ta paguajë dënimin me gjobë, i njëjti konform dispozitave të nenit 46 par.4 i zëvendësohet me dënim me burgim ashtu që njëzetë (20) euro gjobë të papaguara do të jenë ekuivalente me një (1) ditë burg.

Në dënimin me burgim do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në ndalim nga data 24.04.2021 deri me datën 26.04.2021.

Të dëmtuarit: L.M. nga fshati G.Komuna Ferizaj, E.H. nga fshati G., komuna Ferizaj, D.Sh. nga K. Republika e Maqedonisë Veriore, J.B. me vendbanim në rrugën “Ib..”, nr..., Kumanivë, Republika e Maqedonisë Veriore, B.B me vendbanim në rrugën “Ib..”, nr..., Kumanivë, Republika e Maqedonisë Veriore si dhe përfaqësuesit e të dëmtuarve “V.” në Ferizaj rruga “A..”, “H.P.” në Ferizaj, rruga e ... dhe “P...” në Ferizaj për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen ne kontest civil.

Obligohet i akuzuari në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 € /njëzet/ euro si dhe për fondin e kompensimit të viktimave të dhunës shumën prej 20€ /njëzetë / euro, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

## **A r s y e t i m i**

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzat PP.II.nr.120/2021 e datës 08.03.2024 dhe PP/II.nr.678/2021 e datës 07.05.2021, ka ngarkuar të akuzuarin B.R. për veprat penale vjedhje

e rëndë nga neni 315 par.1, nën par.1.1 të KPRK-së dhe vjedhja nga neni 313 par.1 të KPRK-së dhe veprës penale në vazhdim vjedhja nga neni 313 par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

Gjykata, konform nenit 35 par. 1 dhe 8 të KPPRK-së, sipas detyrës zyrtare si dhe duke marr edhe mendimin e palëve ne procedure, ka marrë aktvendimin për bashkimin e procedurave penale sipas numrit të lëndëve të evidentuara 2021:045017, 2021:088732 dhe aktakuzat me numër PP/II.nr.120/21 e datës 08.03.2021, dhe PP/II.nr.678/2021 e datës 07.05.202, kundër të pandehurit B.R., për shkak të veprave penale vjedhje e rëndë nga neni 315 par.1, nën par.1.1 të KPRK-së dhe vjedhja nga neni 313 par.1 të KPRK-së dhe veprës penale në vazhdim vjedhja nga neni 313 par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, pasi që objekti dhe dashja e akuzës është e njëjtë, dhe kryesi i veprës penale i njëjtë si dhe për shkak te parimit te ekonomizimit të shpenzimeve të procedurës, gjykata me aktvendim të veçantë ka bashkuar lëndët e sipër cekura, me ç’rast procedura do të udhëhiqet dhe evidentohet sipas numrit 2021:045017.

Gjykata, pas vlerësimit të të gjitha provave, gjykata nuk detyrohet me propozimet e prokurorit të shtetit lidhur me kualifikimin ligjor të veprës, bëri ri cilësimin juridik të veprës penale për të pandehurin dhe atë: nga vepra penale vjedhja nga neni nga neni 313 par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, në veprën penale vjedhja nga neni 315 par.1 nënpar. 1.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-se.

Pasi që gjykata e ka udhëzuar të akuzuarin në kuptim të nenit 241 par.1 të KPPK-se dhe pasi që i akuzuari ka deklaruar se i ka kuptuar në tërësi udhëzimet e dhëna nga gjykata, në pajtim me nenin 241 par.3 të KPPK-së shqyrtimi fillestar ka vazhduar me leximin e aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit dhe pasi që gjykata është bindur se i akuzuari e ka kuptuar në tërësi aktakuzën, duke vepruar sipas nenit 241 par. 4 të KPPK-së i ka ofruar mundësinë që të deklarohet lidhur me fajësinë apo pafajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar.

I akuzuari B.R. lidhur me të drejtën për tu deklaruar lidhur me fajësinë apo pafajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale që e ngarkon aktakuza, se pranimin e fajësisë e bënë në mënyrë vullnetare dhe se është i vetëdijshëm për pasojat që mund të vijnë si rezultat i pranimit të fajësisë, duke shtuar se i vjen keq për këtë vepër penale, ka kërkuar falje publike, është penduar për veprën e kryer si

dhe e ka lutur gjykatën që të merr parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe t'i shqiptojë një dënim më të butë.

Prokurori i shtetit Besnik Nuredini lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga i akuzuari, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare, i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe ky pranim i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza andaj i ka propozuar gjykatës që ta marrë parasysh pranimin e fajësisë nga i akuzuari, të njëjtën ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit.

Meqë i akuzuari e ka pranuar fajësinë, gjyqtarja e vetme gjykuese ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara me dispozitën e nenit 242 par.2 të KPPK-së, i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, dhe në provat materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës siç janë: vërtetimi mbi konfiskimin e sendeve nga i pandehuri B.R. i dt. 26.08.2020, portofoli i sekuestruar nga i pandehuri, veshmbathjet ngjyre te kuqe dhe te kaltër, një çantë ngjyrë e zezë ” Calvin Klen”, një çantë e llojit “Gucci” ngjyrë e kuqe, video-incizimet e datës 21.08.2020 (CD), procesverbali i këqyrjes se sendeve, vendimi numër 398/20 Gjykata -Prizren, flete lëshimi i qendrës paraburgimit Gjilan, shpallja në kërkim të të pandehurit B.R.t, analiza e pamjeve filmike, informacionet nga drejtoria vendore e policisë se Durrësit në Shqipëri, vendimi për bashkimin e procedimeve penale me nr. 1662/20, kërkesa për transferimin e procedimit penal te dt. 11.11.2020, autorizimi për futjen e të pandehurit në stop-listë e dt. 24.02.2021, kërkesa e departamentin për bashkëpunim ndërkombëtar juridik me nr.217 të dt. 21.01.2021, vërtetimi mbi sekuestrimin e sendeve i datës 24.04.2021 dhe mbi kthimin e sendeve i datës 29.04.2021, të dëmtuarës “V..”, vërtetimi mbi sekuestrimin e sendeve i datës 24.04.2021, të dëmtuarës “P..”, dhe të dëmtuarave L.M. dhe E.H. vërtetimin mbi kthimin e sendeve të sekuestruara i datës 24.04.2021, të të dëmtuarës “P..”, dhe të dëmtuarave L.M. dhe E.H vërtetimi mbi sekuestrimin e sendeve i datës 24.04.2021, të dëmtuarës “H.P.”, fotodokumentacioni si dhe shkresat të tjera të cilat gjenden në lëndë.

Pasi që i akuzuari ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, gjyqtarja e vetme gjykuese konform nenit 242 par. 6 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e

nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të figurës së veprës penale në vazhdim vjedhje e rëndë nga neni 315 par.2, nën par.2.6 lidhur me par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, ashtu siç është theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi, të përshkruar në datën, vendin, kohën dhe mënyrën apo rrethanat e kryerjes.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së, gjykata bëri zbutjen e dënimit, nga minimumi paraparë ligjor nga 3/tri/ vite burgim në 1/një/ vit burgim dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese se në shqyrtimin fillestar i akuzuari e ka pranuar fajësinë, duke e shprehur pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer, kërkim faljen publike, premtimin se nuk do të përsërisë vepra të tilla penale, ndërsa si rrethana rënduese gjykata pati parasysh faktin se i pandehur është përsëritës i veprave penale apo të ngjashme dhe ka qenë më parë i dënuar për vepra të njëjta apo të ngjashme me aktgjykimin e plotfuqishëm me numër P.nr.172/20 i datës 05.03.2021, andaj duke marrë për bazë të cekurat më lartë, gjykata të pandehurin e gjykon me dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi me bindjen se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit në kuptim të preventivës speciale dhe asaj gjenerale.

Vendimi mbi llogaritjen e paraburgimit në dënimin e shqiptuar është marrë duke u bazuar në nenin 79 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet paushallë është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 452 paragrafi 1 lidhur me nenin 449 paragrafi 1 dhe 2 nën paragrafi 2.6 të KPRK-së.

Vendimi mbi Kompensimin e Viktimave të Krimit është marrë në kuptim të nenit 36 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit Nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ  
Departamenti i përgjithshëm, Divizioni penal

2021:045017 datë 24.06.2024

Zyrtari Ligjor  
Ymri Ibrahim

Gjyqtarja e vetme gjykues  
Hakile Ilazi

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të i dorëzohet në kopje të mjaftueshme Gjykatës Themelore në Ferizaj për Gjykatën e Apelit.